



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 03-111/01-22965
Datë: 07.05.2025



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të punës

Një (1) Shef/e i/e Sektorin të Stomatologjisë QKMF-ë Lipjan

Detyrat dhe përgjegjësitë për Shef/e i/e Sektorit të Stomatologjisë:

1. Organizon punën në kuadër të Sektorit të Shëndetit Oral.
2. Është përgjegjës për kualitetin e punës dhe ndërmerr masa adekuate për përmirësimin e tyre në Sektorin e Shëndetit Oral.
3. Është përgjegjës për mirëmbajtjen e aparaturës dhe shpenzimit sa më racional të materialit stomatologjik.
4. Bën kërkesa për pajisje dhe material stomatologjik.
5. Është përgjegjës për avancimin e shëndetit oral për të gjithë banorët e Komunës.
6. Kujdeset për plotësimin adekuat të dokumentacionit në kuadër të Sektorit.
7. Kujdeset për shfrytëzim adekuat të aparaturës dhe shfrytëzimi racional të materialit.
8. Mbikëqyrë zbatimin dhe përdorimin e drejtë të masave dhe mjeteve mbrojtëse në punë në Sektorin e Shëndetit Oral
9. Përpilon orarin e rregullt të punës si dhe kujdestarive.
10. Thërret dhe mbanë mbledhje të kolegjit profesional në kuadër të sektorit.
11. Përcjellë disiplinën e punonjësve në Sektorin e Shëndetit Oral dhe raporton për të njëjtit
12. Shqyrton çështjen lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në Sektorin e Shëndetit Oral merr qëndrim dhe propozim lidhur me zgjedhjen e këtyre çështjeve.
13. I propozon këshillit profesional të QKMF-së nevojën edhe arsyetimin profesional dhe implementimin e metodave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike.
14. Harton planin dhe programin e shërbimit dhe ofron shërbime dentalë adekuate nëpër shkolla.
15. Pavarësisht profilit detyrimi i tij për respektimin dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit të Shëndetësisë Statutit të Komunës, statutit të QKMF-se dhe akteve tjera nënligjore të institucionit si dhe respektimin e pavarësisë profesionale të secilit, në interes të sëmurëve dhe ruajtjes së emrit të mirë të profesionit dhe të institucionit mjekësor.
16. Përpilon raporte periodike dhe planin e punës.
17. Kryen punët e Stomatologut.

18. I përgjigjet situatave emergjente dhe gjendjeve të jashtëzakonshme në çdo kohë dhe kërkon mbështetje në rast të situatave emergjente me kërkesën e Drejtorit të QKMF-së aty ku ushtrohet profesioni i stomatologjis.
19. Kryen edhe punë tjera sipas urdhurit të Drejtorit të QKMF-se

Kushtet dhe kriteret për Shef/e i/e Sektorin të Stomatologjisë QKMF-ë Lipjan:

- Diploma Universitare-Fakulteti i Stomatologjisë.
- Licenca e Punës-valide
- Certifikata Shëndetësore jo më e vjetër se gjashtë muaj
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan jo më e vjetër se gjashtë muaj.
- Vërtetimi i provës së punës së paku 3 vite
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime jo më e vjetër se gjashtë muaj
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë zotësi të plotë veprimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vërtetimi nga punëdhësi).
- **Paga mujore për Shef/e i/e Sektorin të Stomatologjisë QKMF-ë Lipjan:**

Koeficienti: Klasa H-7 koeficienti 12.5

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të caktuar mandat 4 vite.

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data 08.05/2025 deri me 06.06/2025 që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mund të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatet të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur (nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të jenë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

**Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini**

